



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

Nr. 1321/4 Prot.

Vlorë, më 07.07.2023

VENDIM

Nr. 36, datë 07.07.2023

PËR

NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E SENATIT AKADEMIK NR.105, DATË 20.11.2020 MBI
ELEMENTET PËRBËRËS DHE FORMËN E DIPLOMËS SË LËSHUAR NGA
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI", VLORË

Në mbështetje të nenit 38 të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", të nenit 19, të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, Udhëzimi nr.10, datë 30.03.2020, "Për përcaktimin e elementëve përbërës, formën e diplomës ose certifikatës së lëshuar nga IAL-të dhe procedurës së regjistrimit të tyre në regjistrin e diplomave ose certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor", ndryshuar me Udhëzimin e MAS nr.5, datë 03.03.2021 dhe Udhëzimin e MAS me nr.14 datë 21.06.2022, si dhe referuar propozimit të Zëvendësrektorit Akademik ardhur me shkresën nr.1220, prot, datë 21.06.2023, Senati Akademik në mbledhjen e datës 06.07.2023

VENDOSI:

1. Të miratojë ndryshimet në Vendimin e Senatit nr.105, datë 20.11.2020 bazuar në formatin e miratuar nga MAS PËR PROGRAMET E CIKLIT të I^{re} dhe të II^{te} të studimeve si më poshtë:

I. Në formatin e diplomës së Ciklit I^{re} të studimeve (Bachelor)

a. Në pikën 10

- **Hiqet**- "Data e regjistrimit në institucion për programin përkates"
- **Shtohet**- "Kohëzgjatja normale e programit të studimit".
- **Hiqet**- "Numri i regjistrimit të veçante"
- **Zëvendësohet** - "ID e Maturës Shtetërore" me "ID e Maturës Shtetërore/Nr.i vlefshmërisë së diplomës(Nr.i regjistrimit)"
- **Zëvendësohet** -Forma e studimit" me "Forma e studimeve"


b. Në pikën 12

- Shënimi në fund të diplomës "Kjo diplomë shoqërohet nga suplementi i saj" shkruhet me shkrim(Berlin Sans FB 10 pt).

II. Në formatin e diplomës së Ciklit II^{te} të studimeve(MP dhe MS).

a) Në pikën 10





- **Hiqet**-“Data e regjistrimit në institucion për programin përkatës”.
- **Shtohet**-“Kohëzgjatja normale e programit të studimit”
- **Zëvendësohet**-“Nr. i matrikullimit të Ciklit paraardhës të studimeve” me “Nr. i matrikullimit të Ciklit paraardhës/ Nr.i regjistrit në vërtetimin e njësimit të diplomës”.
- **Zëvendësohet**-“Forma e studimit” me “Forma e studimeve”.

b) Në pikën 12,

- Shënimi në fund të diplomës “Kjo diplomë shoqërohet nga suplementi i saj” shkruhet me shkrim (Berlin Sans FB 10 pt).
2. Bashkëlidhur këtij Vendimi formatet e diplomës për Ciklin e I^{rë} dhe të II^{të} të studimeve.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Njësitë Kryesore, Zëvendësrektorit Akademik, Drejtoria e Edukimit për Ciklin e I^{rë} dhe të II^{të} të Studimeve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

PROF. DR. ROLAND ZISI

